



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 737 / Prot. 11

Vlorë më, 26.03 .2024

VENDIM
Nr. 13, datë 25.03.2024

PËR
ÇELJEN E PROCEDURAVE PËR NGRTJEN E KOMSIONIT INSTITUCIONAL
ZGJEDHOR (KIZ) NË UV

Në zbatim të nenit 131 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Urdhrit të MAS, Nr.101, datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", të Urdhrit të Rektorit të UV nr.48 , datë 19. 03. 2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 25.03.2024,

VENDOSI:

1. Te miratojë çeljen e procedurave për ngritjen e Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ) në UV.
2. Të miratojë përbërjen e KIZ, nga 5 (pesë) anëtarë; 4 personel akademik, nga një për çdo fakultet dhe 1 student. Në rast se nuk ka kandidatë të paraqitur nga një fakultet, atëherë vijon lista më poshtë.
3. Të miratojë çeljen e procedurës për vetëkandidim për anëtarë të Komisionit Institucional Zgjedhor dhe sekretar të KIZ-it të UV si dhe njoftimin zyrtar me kriteret përkatëse, drejtuar personelit akademik dhe studentëve, në funksion të regjistrimit për vetëkandidim, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë periudhën kohore të pranimit të vetëkandidimeve e cila zgjat 5 (pesë) dite pune, duke filluar nga data e nënshkrimit dhe shpalljes nga Kryetari i SA të këtij vendimi.
5. Vetëkandidimet dorëzohen në Zyrën e Arkivit Qëndror të UV-së dhe administrohen nga sekretaria e SA.
6. Vendimi shpallet në web-in e UV-së dhe i bëhet me dije personelit akademik, drejtuesve të njësisë bazë dhe kryesore, si dhe Këshillit Studentor të UV, për njohje dhe zbatim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETAR I SENATIT AKADEMIK
Prof.As. Xhiliola AGARAJ (SHEHU)

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Faqe 1 nga 1

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

